



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Tiranë, më 15.10.2019

SQARIME NR. 1

“Mbi dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit, “Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me objekt: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”

Në zbatim të pikës 1 dhe 2, të nenit 42, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe nenit 62 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, për procedurën e prokurimit Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar-Prokurim Elektronik, me objekt: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, me REF-31606-07-25-2019, me fond limit: 2.800.347.570 (dy miliard e tetë qind milion e treqind e dyzetë e shtatë mijë e pesë qind e shtatëdhjetë) Lekë (pa TVSH), përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave, organi qendror blerës vendosi të bëjë publikojë disa sqarime mbi dokumentet e tenderit, përmes hartimit të këtij dokumenti dhe si më poshtë:

Pika 2.11 në “Njoftimin e Kontratës” në dokumentet e tenderit ku përcaktohet : “Ndarje në Lote: Jo.”, sqarohet si vijon:

Për shkak të karakterit shumë të ndërlikuar dhe të veçantë të mallrave e shërbimeve në lidhje me to, ku kombinohen disa detyra, është e domosdoshme që mallrat dhe shërbimet objekt prokurimi, të furnizohen, sigurohen dhe ekzekutohen nga 1(një) ofertues, i cili mund të jetë i organizuar në formën e lejuar nga ligji dhe dokumentat e tenderit, si bashkim i 2 ose me shumë operatorëve ekonomik apo nëpërmjet nënkontraktimit të lejuar deri në 40% të vlerës së mallrave dhe shërbimeve që kërkohen të prokurohen. Për shkak të plotësimit të nevojës së autoritetit kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me një lloj veshje uniform, të njëjtë nga koka te këmbët për të gjithë punonjësit e policisë (uniforma dhe këpucë), nga ana teknike dhe organizative është e nevojshme kryerja e furnizimit me uniforma dhe mbajtja e kontakteve të autoritetit kontraktor me 1(një) ofertues, i cili duhet të realizojë edhe porositjen e shpërndarjen nëpërmjet sistemit të shpërndarjes së uniformës, tek të gjithë punonjësit e policisë së shtetit në të gjithë vendin, si dhe pajisjen e tyre me karta, me të njëjtat standarde, për një periudhë 4 vite. Pra, për shkak të kompleksitetit “mallra dhe shërbime”, autoriteti kontraktor duhet të ketë marrëdhënie vetëm me një kontraktor, që mund të jetë një operator ekonomik ose një bashkim i dy a më shumë operatorëve ekonomik. Për rrjedhim, procedura e prokurimit nuk është organizuar në lote të vecanta.

Pika 4.1 në “Njoftimin e Kontratës” në dokumentet e tenderit ku përcaktohet: “ Lloji i procedurës: E Kufizuar”, sqarohet si vijon:

“Procedurë e kufizuar” është një prej llojeve të procedurave të parashikuara nga ligji për prokurimin publik, pika 18 e nenit 3 të LPP-së, përmes së cilës çdo operator ekonomik mund të kërkojë të marrë pjesë (faza e parë - Parakualifikimi), por vetëm operatorët ekonomikë të përzgjedhur në fazën e parë, mund të dorëzojnë oferta teknike dhe ekonomike (faza e dytë - Ftesa për Ofertë). Ashtu sic edhe ligji parashikon, procedura e kufizuar mund të përdoret atëherë kur është e domosdoshme të bëhet dallimi ndërmjet fazës së përzgjedhjes, ku trajtohet kualifikimi i kandidatëve dhe fazës së përcaktimit të kontratës fituese, ku shqyrtohet oferta teknike dhe ekonomike.

Procedura e kufizuar (me 2 faza) është përdorur për shkak të karakterit shumë të ndërlikuar dhe të veçantë të mallrave e shërbimeve në lidhje me to, të cilat mund të furnizohen, sigurohen dhe ekzekutohen nga operatorë ekonomikë, të cilët kanë kapacitetin e duhur teknik, profesional dhe financiar, si dhe duke qenë se është ekonomikisht më e leverdisshme, që fillimisht të shqyrtohen kapaciteti dhe kualifikimet e operatorëve ekonomikë të interesuar (faza e parë) dhe më pas të ftohen të paraqesin ofertat teknike dhe ekonomike, ata që kanë kualifikimet minimale të caktuara (faza e dytë).

Të dy fazat e kësaj procedure zhvillohen në rrugë elektronike nëpërmjet platformës së prokurimit elektronik (përvec kampioneve/mostrave të mallrave që dorëzohen fizikisht ditën e hapjes së ofertave në fazën e dytë). Ndarja në dy faza paraqet kosto më të ulëta ekonomike për operatorët ekonomik të interesuar, të cilët nuk janë të detyruar të përgatisin ofertat ekonomike dhe teknike që në fazën e parë (psh. kampione/mostra të mallrave), si dhe kosto më të ulëta administrative për organin qendror blerës.

Në përzgjedhjen e kësaj procedure janë mbajtur parasysh aspektet për rëndësinë dhe natyrën e objektit të prokurimit, që përfshijnë kombinimin i disa detyrave deri në marrjen e produktit përfundimtar. Gjendja e tregut vendas dhe atij të huaj e mundëson pjesëmarrjen në fazën e parë të parakualifikimit, të më shumë se dy operatorëve ekonomik që mund të realizojnë objektin e prokurimit, të cilët mund të marrin pjesë edhe si bashkim operatorësh ekonomik. Mallrat dhe shërbimet në lidhje me to, nuk gjenden lehtësisht në treg dhe kanë specifikime teknike e standarde të vecanta, të cilat janë të miratuara me akt nënligjor.

Pika 4.3 dhe 4.4 në “Njoftimin e Kontratës” në dokumentet e tenderit ku përcaktohet, afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e kërkesave për pjesëmarrje, sqarohet si vijon:

Afati kohor në dispozicion të operatorëve ekonomik për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje në Fazën e parë - Parakualifikimi, i përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe njoftimin e kontratës ka qenë 25 ditë, nga 20 ditë që është afati minimal ligjor, duke u konsideruar mëse i mjaftueshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e dokumentacionit minimal ligjor të kërkuar, të cilat cdo kompani vendase apo e huaj, nëse i ka, normalisht i disponon në çdo kohë dhe në formën e kërkuar. Në këtë fazë parakualifikuese, operatorëve ekonomik nuk ju kërkohet të përgatisin dhe paraqesin kampione/ mostra të uniformave por vetëm dokumentacionin minimal ligjor të përcaktuar për këtë fazë.

Në përfundim të vlerësimit të kërkesave për pjesëmarrje në fazën e parë dhe respektimit të afateve ligjore të ankimit administrativ, nëse do të ketë të paktën dy operatorë ekonomik të kualifikuar, atyre do t’ju dërgohet Ftesa për Ofertë në të cilën do të përcaktohet edhe afati kohor në dispozicion për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës teknike dhe ekonomike për këtë fazë të dytë.

Në dokumentet e tenderit nuk është përcaktuar një afat për dorëzimin e mostrave, duke qenë se dorëzimi

i tyre nuk është kërkuar në Fazën I - Parakualifikimi por është kërkuar në Fazën II - Oferta Teknike. Sqarojmë se në përfundim të vlerësimit të kërkesave për pjesëmarrje në Fazën I - Parakualifikimi dhe respektimit të afateve ligjore të ankimimit administrativ, nëse do të ketë të paktën dy operatorë ekonomik të kualifikuar, atyre do t'ju dërgohet Ftesa për Ofertë në të cilën do të përcaktohet edhe afati kohor në dispozicion për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës teknike dhe ekonomike për këtë fazë të dytë.

Afati minimal i përcaktuar në ligj për dorëzimin e ofertave në fazën e dytë është 20 ditë, por duke patur parasysh kompleksitetin dhe rëndësinë e procesit të përgatitjes së ofertës teknike dhe ekonomike, ku përfshihen edhe kampionet/mostrat e uniformës dhe dokumenta të tjerë teknik, afati që do të lihet në dispozicion do të jetë mëse i mjaftueshëm dhe i arsyeshëm për përgatitjen e ofertave nga të gjithë operatorët e kualifikuar për fazën e dytë, duke patur parasysh edhe argumentat e paraqitura nga ana juaj për kohën e përgatitjes së mostrave/ kampionëve.

Pika 4.6 në “Njoftimin e Kontratës” në dokumentet e tenderit ku përcaktohet: ”Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Anglisht X“, sqarohet si vijon:

Gjuhët për hartimin e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje të përcaktuara në paragrafin 4.6 të dokumenteve të tenderit janë gjuha Shqip dhe/ose Anglisht. Për dokumentat e lëshuara nga institucione shqiptare, publike dhe private, nuk kërkohet të bëhet përkthimi dhe dorëzimi i tyre edhe në gjuhën angleze. Gjithashtu sqarojmë se dokumentat për zgjidhjen teknike dhe ofertën ekonomike mund të paraqiten në një nga gjuhët e lejuara, ose Shqip ose Anglisht. Në lidhje me dokumentat e tenderit të cilat janë publikuar në gjuhën shqipe dhe angleze, sqarojmë se në rast të ndonjë gabimi në përkthim prevalon gjuha shqipe.

Kriteri i përcaktuar në gjurmën “a” të seksionit 2.1 “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë” në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit (Faza I - Parakualifikimi) të dokumentave të tenderit, sqarohen si vijon:

Në këtë kriter është shprehur qartë dhe saktë se Leja e Mjedisit e tipit B ose C kërkohet vetëm për kandidatët me aktivitet të veprimtarisë në fushën e prodhimit të këpucëve në Shqipëri, duke cituar njëkohësisht edhe mbështetjen e këtij kriteri në Ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar. Qëllimi është marrja e garancive për mbrojtjen e mjedisit shqiptar nga kompani që prodhojnë këpucë në Shqipëri, ndërsa për kompanitë që prodhojnë këpucë jashtë vendit tonë (operator të huaj) nuk është kërkuar ndonjë dokument i tillë.

Kriteri i përcaktuar në pikën 2 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit (Faza I - Parakualifikimi) të dokumentave të tenderit, sqarohet si vijon:

Në lidhje me dokumentacionin që duhet të paraqitet në rastin kur kandidati nuk është prodhues i artikujve të uniformës, për të vërtetuar lidhjen midis tij dhe prodhuesit, mund të paraqitet cdo dokument provues për marrëdhënien midis palëve për këtë objekt prokurimi, i cili duhet të përmbajë të dhëna të

plota të prodhuesit si: ëbsite, e-mail, telefon, të nevojshme në rast verifikimi. Forma e dokumentit apo dokumentave provues mund të jetë autorizim/ vërtetim i lëshuar nga prodhuesi ose marrëveshje/kontratë midis prodhuesit dhe tregtuesit të autorizuar, ose cdo lloj dokumenti provues i barazvlefshëm me to.

Kriteret e përcaktuara në pikat 12 dhe 13, në Faza II “Oferta teknike” - në Shtojcën 10 të dokumentave të tenderit, sqarohen si vijon:

Në tabelat e mostrave / kampioneve që kërkohen të paraqiten në ofertën teknike në Fazën II, ku janë përcaktuar mostrat / kampionet e disa prej artikujve që kërkohen të prokurohen, në kolonën e fundit "Dokumentacioni shoqërues" është bërë ndarja qartë dhe saktë, që për disa artikuj me tekstil të njëjtë, të paraqitet një skedë teknike si dhe një raport testimi/ fletë analizë nga laborator, për një lloj të lëndës së parë. Paraqitja e dokumentacionit teknik raport testimi/ fletë analiza për artikuj të njëjtë në përbërje është e lejuar sipas dokumentave të tenderit, përderisa në çdo skedë teknike dhe raport testimi / fletë analizë të evidentohet qartë dhe saktë lënda e parë për të cilën jepen të dhënat teknike, sipas skedës apo rezultateve të testimit / analizës.

Përsa më sipër, njoftojmë se në zbatim të pikës 2/1 të nenit 42 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e kërkesave për pjesëmarrje (Faza I - Parakualifikimi), shtyhet si vijon:

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **05/11/2019** (dd/mm/vvvv) Ora: **10:00**

Vendi: www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së www.app.gov.al .

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **05/11/2019** (dd/mm/vvvv) Ora: **10:00**

Vendi: www.app.gov.al ; Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme, Tiranë.

Hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al, si dhe pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.

Gjithashtu, sqarojmë të gjithë operatorët ekonomik të interesuar, se për shkak të disa ndryshimeve / modifikimeve në dokumentat e tenderit sipas **Shtojcës nr.1 datë 15.10.2019** të publikuar nga organi qendror blerës, për lehtësimin e punës së operatorëve ekonomik në evidentimin e ndryshimeve / modifikimeve, organi qendror blerës ka publikuar edhe dokumentat :

“Dokumentat e Tenderit - të ndryshuara” në të cilin janë reflektuar të gjitha ndryshimet / modifikimet e bëra sipas Shtojcës nr.1 të datës 15.10.2019, si dhe dokumentat : “Aneksi nr.1 - i ndryshuar – Kostume”, “Aneksi nr.2 - i ndryshuar - Këmisha” , “Aneksi nr.3 - i ndryshuar - Materiale doku”, “Aneksi nr.4 - i ndryshuar - Trikotazhe”, “Aneksi nr.5 - i ndryshuar - Xhupat”, “Aneksi nr.6 - i ndryshuar - Aksesore”, “Aneksi nr.7 - i ndryshuar - Këpucë”, “Aneksi nr.8 - i ndryshuar - Grada, Shenja, Stema”, “Aneksi nr.9 - i ndryshuar - Sistemi Elektronik i Shpërndarjes” me skicimet,

parametrat teknik, specifikimet e materialeve dhe termat e referencës, të ndryshuara / modifikuara.